



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.984/ 9 prot.

Datë 08.05.2026

V E N D I M
Nr. 617 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.571/2026, datë 29.04.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me NIPT J62426002Q.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës.
Adresa: Sheshi Skënderbej, Lagjja 5, Kukës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:
I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr.571/2026, datë 29.04.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Të pranojë pjesërisht pretendimet e ankesës për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit sipas Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij Vendimi me publikimin e shtojcës përkatëse.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 2083/1 prot., datë 05.05.2026, protokolluar me tonën nr. 984/6 prot., datë 07.05.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 571/2026, datë 29.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 2083/1 prot., datë 05.05.2026, protokolluar me tonën nr. 984/6 prot., datë 07.05.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 571/2026, datë 29.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme, të autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcë për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Referuar vendimit të KPP-së si edhe përmbajtjes së shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet dhe konstatoi, se autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar nuk ka pasqyruar të gjitha modifikimet në specifikimet teknike të ankimuara nga operatori ekonomik dhe të pranuar nga KSHA e konkretisht pretendimet e operatorit:

Tek formulari i sasisë janë përcaktuar 300 pako ndërkohë është kërkuar 250 cp për secilën madhësi. Korigjoni dhe saktësoni sasinë e kërkuar për këtë artikull sipas madhësive të kërkuara tek specifikimet teknike.

AK ka pranuar pretendimin dhe ka percaktuar në shtojcën e modifikuar si vijon:

Kërkoheq që madhësia e tyre të jete e ndryshme duke përsjire 150 cope (25mm) dhe 150 cope (28 mm, 33 mm dhe 50 mm).

II.2. Sa më sipër konstatuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar plotësisht Vendimin e KSHA-së pasi duhet të specifikohte sasinë për cdo përmasë të **Kapese letrash gjarperueshe te madhesive ndryshme (paper clip) për permasat 28 mm, 33mm dhe 50mm, siç ka përcaktuar sasinë për paper clip 25mm.**

II.3. Përsa konstatuar Komisioni gjykon që AK duhet rishikojë specifikoimet teknike të ankimuarra dhe në veçanti të saktësojë sasinë për artikullin **Nr.12** Kapëse letrash të madhësive të ndryshme. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën me të gjitha ndryshimet e kërkuara nga ankimuesi dhe të pranuarra nga KSHA në zbatim të vendimit mbi pranimin e ankesës.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, *Mallra*, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën në SPE me të gjitha modifikimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

